

Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Komuna



Maj 2023

Buxheti i Përgjegjshëm Gjinor në Komuna

Maj 2023

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
1. Hyrje	4
2. Si mund të ndikoj ndarja e buxhetit në barazinë gjinore?	6
3. Institucionalizimi i Buxhetimit të përgjegjshëm gjinor	7
4. Buxheti i përgjegjshëm gjinor në procesin buxhetor	8
5. Buxheti i përgjegjshëm gjinor në procesin buxhetor për Buxhetin 2023	8
6. Përfundim dhe rekomandime	16
Shtojcat	17

Përmbledhje ekzekutive

Barazia gjinore është një nga vlerat kushtetuese në Kosovë. Mirëpo, në praktikë, shoqëria kosovare mbetet një ndër shoqëritë më diskriminuese sa i përket barazisë gjinore, ku gratë janë të nënpërfaqësura në jetën politike e në tregun e punës, përfitojnë më pak nga fondet publike, zotërojnë më pak patundshmëri, etj. Për të zbutur dhe eliminuar këto pabarazi, një ndër instrumentet e zbatuara nga institucionet publike është edhe buxheti i përgjegjshëm gjinor (BPGj). BPGj e bënë këtë përmes ndarjes së fondeve publike në bazë të nevojave, interesave dhe prioriteteve të ndryshme të grave, burrave, vajzave dhe djemve të profileve të ndryshme.

Nga viti 2015 kur ka hyrë në fuqi Ligji për barazi gjinore, buxheti gjinor është obligim ligjor për të gjitha institucionet. Mirëpo, edhe pse kanë kaluar gati tetë vite nga hyrja në fuqi e Ligjit për barazi gjinore, organizatat buxhetore nuk po e respektojnë këtë detyrim ligjor. Analiza mbi Shpenzimet Publike dhe Llogaridhënien Financiare (ang: PEFA) në vitin 2021 gjente se asnjë organizatë buxhetore e nivelit qendror dhe lokal nuk kryen analizë gjinore gjatë procesit të hartimit të projektbuxhetit.

Instituti GAP ka analizuar procesin dhe ndikimin e BPGj tek organizatat buxhetore të nivelit lokal (komunat). Përmes të drejtës së qasjes në dokumente publike, GAP ka siguruar shtojcat e BPGj sipas qarkoreve buxhetore për të gjitha komunat që nga viti 2017. Të dhënat e ofruara nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve tregojnë se nga 2017 deri 2023, në asnjë vit nuk ka ndodhur që të gjitha komunat të dorëzojnë të plotësuar shtojcat e BPGj. Në shumë raste, edhe kur dorëzohen, shtojcat e BPGj janë me shumë gabime në të dhëna. Për më tepër, Instituti GAP ka arritur të gjej vetëm dy shembuj kur komunat kanë kryer analizë gjinore për efektet e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore tek gratë dhe burrat.

Sa i përket procesit të hartimit të buxhetit për vitin 2023, 33 komuna (86.8%) kanë ofruar të dhëna për punësimin e grave dhe burrave në sektorin publik komunal; 34 komuna (89.5%) kanë ofruar informata të plota lidhur me shpërndarjen vjetore të buxhetit në paga; 25 komuna (65.8%) kanë ofruar të dhëna për numrin e grave dhe burrave që mund të përfitojnë subvencione; 26 komuna (68.4%) kanë dhënë informata të plota lidhur me shumën e subvencioneve të planifikuara e të ndara sipas gjinisë; 31 komuna (81.6%) kanë plotësuar të dhënat e BPGj sa i përket nivelit të pagës për gratë dhe burrat e punësuar në sektorin publik.

Në 33 komunat që kanë plotësuar shtojcën për BPGj, del se janë të punësuar në total 18,739 gra (48.8%) dhe 19,626 burra (51.2%). Prej 34 komunave të cilat kanë plotësuar shtojcën për BPGj, në 22 prej tyre (64.7%) burrat marrin pjesën më të madhe të buxhetit të destinuar për paga, ndërsa gratë dominojnë në këtë aspekt te 12 komunat e tjera (35.3%). Të dhënat tregojnë se në Komunën e Prishtinës gratë janë më të shumta në numër në kategorinë e pagave mbi 600 euro, kurse në të gjitha komunat tjera burrat dominojnë në pozitë ku niveli i pagave është mbi 600 euro. Përkundër asaj që në vitin 2023 parashihet që në total më shumë gra se burra të përfitojnë subvencione nga komunat, sa i përket vlerës së subvencionimit, 14 nga 25 komuat që kanë ofruar informata të plota, parashohin subvencionim në vlera më të larta për burra se për gra.

Instituti GAP rekomandon që në procesin e hartimit të buxhetit për vitin 2024, MFPT të shtrëngoj kriteret për aprovimin e buxheteve komunale nëse komunat nuk dorëzojnë të plotësuar edhe shtojcën për BPGj. Po ashtu, buxheti gjinor duhet të përfshihet edhe në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, si dhe të gjitha të dhënat rreth procesit të BPGj duhet të jenë pjesë e Projektbuxhetit të shtetit që dëgohet në Kuvend të Kosovës për aprovim si dhe pjesë e projektbuxheteve komunale për diskutim në kuvendet e komunave.

1. Hyrje

Kushtetuta e Kosovës njih barazinë gjinore si një nga vlerat themelore. Sipas nenit 7 të Kushtetutës, "Republika e Kosovës siguron barazinë gjinore si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë, mundësi të barabarta për pjesëmarrje të femrave dhe meshkujve në jetën politike, ekonomike, sociale, kulturore dhe në fushat të tjera të jetës shoqërore".¹ Kushtetuta po ashtu njih barazinë gjinore si vlerë edhe në përfaqësimin politik, në shërbimin civil dhe në gjyqësi.

Ligji për barazinë gjinore² obligon institucionet publike që të marrin masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përsheptimit të realizimit të barazisë faktike mes gjinive. Këto masa mund të përfshijnë kuota për përfaqësim të barabartë, fuqizimin ekonomik, trajtim preferencial, deri tek përfaqësim të barabartë gjinor prej 50% në të gjitha organet legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore dhe institucionet e tjera publike.³

Sipas Ligjit, me qëllim të parandalimit dhe eliminimit të diskriminimit gjinor, si dhe arritjes së barazisë gjinore, institucionet në të gjitha nivelet e pushtetit janë të obliguara për të zbatuar masa legjislativë dhe masa tjera, duke përfshirë edhe buxhetimin gjinor në të gjitha fushat.⁴

Buxhetimi gjinor njih si fakt atë që buxhetet shtetërore ndikojnë në mënyrë të ndryshme tek burrat dhe gratë, pasiqë gratë, burrat, vajzat, dhe djemtë me aftësi të ndryshme kanë nevoja, interesa dhe prioritete të ndryshme. Vendimet zyrtare mund të ndikojnë ose për të promovuar barazinë gjinore ose përforcojnë pabarazitë ekzistuese. Buxhetimi gjinor përdor politikat fiskale dhe mjetet e menaxhimit financiar publik për të promovuar barazinë gjinore.⁵ Në thelb, buxhetimi gjinor sfidon praktikën e "verbëra apo neutrale ndaj gjinisë" të institucioneve publike të cilat pastaj prodhojnë politika të njëanshme që i shërbejnë kryesisht burrave.⁶

Para se të hyj në fuqi Ligji për barazi gjinore, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT)⁷, kishte filluar pilotimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Komunën e Kamenicës.⁸ Kurse nga viti 2015 u lëshuan qarkoret buxhetore për komuna të cilat obligonin komunat që në procesin e planifikimit të buxheteve për vitin 2016 të ofrojnë të dhëna edhe për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.⁹ Mirëpo, të dhënat e kërkuara në shtojcën e BPGj janë të mangëta dhe nuk përfshijnë të gjitha kërkesat për institucionalizim të plotë të BPGj. Në mënyrë që të institucionalizohet plotësisht BPGj, duhet të bëhet një Vlerësim i Ndikimit Gjinor (VNGj) për çdo politikë publike. Agjencia për Barazi Gjinore ka draftuar një manual të VNGj, i cili është dizajnuar që të ndihmojë të gjithë akterët e përfshirë në fazat e çdo politike apo programi dhe shërben si pikë referimi për të kryer

1 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 7.

Burimi: <https://bit.ly/3ye0VU3> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

2 Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.05/L-20 për barazi gjinore, i cili ka hyrë në fuqi më 2015.

Burimi: <https://bit.ly/3F3rQ8T>. Ky Ligj ka zëvendësuar ligjin e vitit 2007: <https://bit.ly/3STiu5b> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

3 Po aty, neni 6.

4 Po aty, neni 5.

5 IMF. Gender Budgeting in G20 Countries. IMF Working Paper, WP/21/269. November 2021.

Burimi: <https://bit.ly/3mGc4Lp> (hapur së fundmi më 19 prill 2023).

6 Angela O'Hagan. Gender budgeting in Scotland: A work in progress. Women's Budget Group.

Burimi: <https://bit.ly/3ZnKvEJ> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

7 Më 2014 MFPT është emërtuar vetëm Ministria e Financave dhe ka ndërruar emërtim më 2021 pas fuzionimit të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

8 MFPT. Qarkorja buxhetore 2015/1 për komuna. 14 maj 2014.

Burimi: <https://bit.ly/3L1mMWy> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

9 MFPT. Qarkorja buxhetore 2016/02 për komuna. 31 korrik 2015.

Burimi: <https://bit.ly/3T7wnND> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

vlerësime të ndikimit të barazisë gjinore të të gjitha politikave, programeve dhe aktiviteteve, duke përfshirë vlerësime ex-ante¹⁰. Sipas Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024, përkundër përparimeve, obligimi ligjor për buxhetim të përgjegjshëm gjinor, përcaktuar në Ligjin për barazi gjinore nuk po zbatohet.¹¹ BPGj gjithashtu është kërkesë e shumë kornizave ndërkombëtare duke përfshirë Kornizën Plotësuese për Vlerësimin e Menaxhimit të Përgjegjshëm Gjinor të Financave Publike (PEFA GRPFM)¹², si dhe indikatorin 5.c.1 të Objektivave për Zhillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara¹³. Sipas Raportit për vlerësimin e performancës në menaxhimin e financave publike që kryhet nga PEFA, program ndërkombëtar për vlerësimin e praktikave të shpenzimit të parasë publike dhe llogaridhënies financiare, institucionet e Kosovës nuk mbajnë të dhëna të ndara sipas gjinisë të cilat pastaj do të mund të përdoren për planifikim më të mirë buxhetor dhe ndarje më të drejtë të buxhetit, çfarë e bën të pamundur edhe kryerjen e vlerësimit të ndikimit gjinor.¹⁴ Sipas PEFA-s, ndikimi gjinor nuk përfshihet plotësisht në asnjërën nga nëntë fushat e politikave të përgjegjshme gjinore në menaxhimin e financave publike, siç janë: ndikimi gjinor i politikave të propozuara buxhetore; investime publike që marrin për bazë ndikimin gjinor; përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në qarkoret buxhetore; përfshirja e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në projektbuxhetin; të dhëna të ndara sipas gjinisë për përfituesit e shërbimeve publike; mbajtja e shënimeve për shpenzimet buxhetore të ndara sipas gjinisë; raportim i cili bazohet në informata për ndikimin gjinor; vlerësimi i ndikimit gjinor për shërbimet; dhe përfshirja e ndikimit gjinor në procesin e mbikëqyrjes legjislativ.¹⁵

Në këtë raport të shkurtër, Instituti GAP do të ofroj të dhëna rreth asaj se sa komunitat respektojnë qarkoret buxhetore dhe Ligjin për barazi gjinore sa i përket përfshirjes së buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në planifikimin vjetor buxhetor. Përveç kësaj, duke u bazuar në të dhënat e siguruar nga MFPT përmes kërkesës për qasje në shtojcat e planifikimit të buxhetit vjetor komunal sipas qarkoreve buxhetore të dorëzuara nga komunitat, do të ofrohet një pasqyrë rreth asaj se si përfitojnë gratë dhe burrat nga buxheti komunal, konkretisht të dhëna të ndara sipas gjinisë për kategorinë e shpenzimeve për paga, subvencione dhe të të punësuarve.

10 Agjencia për Barazi Gjinore, Manuali i vlerësimit të ndikimit të Barazisë Gjinore, Prishtinë: 2019. Burimi: <https://bit.ly/41q5c3j>

11 Agjencia për Barazi Gjinore. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024, qershor 2020. Fq.23.

Burimi: <https://bit.ly/41QsUgk> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

12 PEFA. Korniza Plotësuese për Vlerësimin e Menaxhimit të Përgjegjshëm Gjinor të Financave Publike (PEFA GRPFM).

Burimi: <https://bit.ly/3MWPjJM>

13 Organizata e Kombeve të Bashkuara. Treguesi 5.c.1: Përqindja e vendeve me sisteme për të ndjekur dhe bërë ndarje publike për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Burimi: <https://bit.ly/3UA8Oh9>.

14 PEFA. Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report – Supplementary Framework for Assessing Gender Responsive Public Financial Management (Annex VI). 17 February 2022. Faqe: 172.

Burimi: <https://www.pefa.org/node/5072>

15 Po aty, faqe 172–174.

2. Si mund të ndikoj ndarja e buxhetit në barazinë gjinore?

Ekzistojnë pabarazi të mëdha në punësim, planifikim të projekteve kapitale, investime publike, ndarje të subvencioneve dhe transfereve sociale, etj.

Sipas një raporti të Institutit GAP, në shërbimin civil në institucione qendrore gratë zënë 41% të vendeve të punës, gjersa në nivel lokal në shërbimin civil gratë përfaqësohen me 33%.¹⁶ Kurse në pozitat drejtuese dhe në nivelin e lartë drejtues pabarazitë janë më të mëdha. Në nivelin qendror gratë mbajnë vetëm 10% të pozitave të larta drejtuese dhe 32% të pozitave drejtuese; gjersa në nivel lokal gratë mbajnë 22% të pozitave udhëheqëse.¹⁷ Sa i përket përfituesve të ndihmës sociale, përfituesit e kategorisë së parë janë 44.7% gra gjersa në kategorinë e dytë vetëm 9.4% e përfituesve janë gra.¹⁸

Një raport i Rrjetit të Grave të Kosovës (RrGK) për programet e mirëqenies sociale identifikoi pabarazi të mëdha në ndarjen e buxhetit për subvencione dhe transfere për gratë dhe burrat. Sipas raportit, 72% e buxhetit për pensionet kontribut-paguese shkon për burrat; 73% e përfituesve të pensioneve të Forcës së Sigurisë së Kosovës janë burra; e burrat përfitojnë më shumë edhe prej programeve aktive të punësimit.¹⁹ Një raport tjetër i RrGK gjeti se vetëm 3% e shumës për subvencione dhe transfere të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ishte ndarë për gratë.²⁰

Një analizë e Grupit të Grave Deputete në Kuvendin e Kosovës për Projektbuxhetin e vitit 2021 gjeti se burrat janë përfituesit kryesorë të 68% e buxhetit të vitit 2021 për subvencione dhe transfere sociale. Nga investimet kapitale përfitues janë kryesisht burrat, ngase në sektorin e ndërtimit burrat përbëjnë 98% të të punësuarve; 94% në sektorin e transportit; 92% në sektorët që merrren me ujë dhe mbeturina; 89% në sektorin e energjisë, 97% në sektorin e minierave, etj.²¹

Sipas Raportit të Performancës së Komunave për vitin 2021, gratë përbëjnë vetëm 6.6% të antarësisë në këshilla lokale, vetëm 7.4% e pronave të reja të regjistruara regjistrohen në emër të të dy bashkëshortëve, vetëm 11.4% e rrugëve janë të emërtuara në emër të grave, gratë përbëjnë 29% të pjesëmarrësve në dëgjime publike, etj.²²

Buxheti është një nga instrumentet kryesore që ka në dispozicion një shtet apo organizatë buxhetore, siç janë komunat. Fatkeqësisht deri më tani buxheti vetëm ka përforcuar pabarazitë gjinore, por nuk ka shërbyer edhe si instrument për uljen e pabarazive.

16 Instituti GAP. Punësimi dhe përfaqësimi i grave në Kosovë – raport statistikor 2020.

Burimi: <https://bit.ly/3L0Q0oh> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

17 Po aty.

18 Po aty. Për të kuptuar më shumë për kategoritë e ndihmës sociale, mund të lexoni këtë analizën e Institutit GAP "Reformimi i Skemës së Ndihmës Sociale" publikuar më 2022. Burimi: <https://bit.ly/3SP86vv>

19 Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës. Buxheti drejt Mirëqenies Sociale – Analizë gjinore+ për informimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në Kosovë 2016–2018.

Burimi: <https://bit.ly/3yk7gxa>

20 Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës. Buxheti për bujqësi dhe zhvillim rural më të mire. Prishtinë, 2017.

Burimi: <https://bit.ly/3Ymuo8R> (hapur së fundmi më 7 mars 2023).

21 Kuvendi i Kosovës – Grupi i Grave Deputete. Analizë e ndikimit gjinor të Projektbuxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021. Nëntor 2020.

22 MAPL. Raporti i Performancës së Komunave 2021. Prishtinë, 2022. Faqe 35. Burimi: <https://bit.ly/2TwbQ5L>

3. Institucionalizimi i Buxhetimit të përgjegjshëm gjinor

Qëllimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor është i trefishtë: promovimi i transparencës dhe llogaridhënies në politikat fiskale; rritja e pjesëmarrjes së përgjegjshme gjinore në procesin buxhetor; dhe promovimi i barazisë gjinore.²³ Sipas praktikave më të mira të BPGj, vlerësimet ex ante të ndikimit gjinor duhet të informojnë buxhetimin bazuar në nevojat aktuale të grave dhe burrave.²⁴

Në vitin 2014, RrGK filloi pilotimin praktik të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në Komunën e Kamenicës.²⁵ Kjo u bë duke u bazuar në një analizë gjinore të nevojave në një nga institucionet publike në këtë Komunë. Manuali praktik i cili u zhvillua nga ky pilotim, ishte institucionalizuar edhe nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike për të zhvilluar trajnime mbi BPGj për zyrtarët e buxhetit nëpër institucione të nivelit qendror dhe atij lokal. Në maj të vitit 2014, Ministria e Financave (tash MFPT) lëshoi qarkoren e parë buxhetore në të cilën u kërkohej komunave që "të punohet drejt zbatimit të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor sipas praktikave ndërkombëtare, duke bërë të dukshme efektet e shpenzimeve publike në barazinë e grave dhe burrave, djemve dhe vajzave në mënyrë që të kontribuohet në efektivitetin dhe transparencën e menaxhimit të financave publike, bazuar në punën e pilot-projektit në Komunën e Kamenicës".²⁶

Një vit më vonë, pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Barazi Gjinore, ministria lëshoi qarkoren e dytë buxhetore për përgatitjen e buxhetit për vitin 2016 me të cilën rekomandoheshin organizatat buxhetore që të plotësojnë tabelat për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor me qëllim të ofrimit të informacionit për objektivat specifike, aktivitetet dhe treguesit për rritjen e barazisë gjinore në sektorë të ndryshëm, në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore. "Kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht një rritje në shpenzime, por përdorim më efikas të burimeve ekzistuese dhe/ose shpërndarje më të barabartë të burimeve ekzistuese", thuhej në qarkoren buxhetore të ministrisë.²⁷

Përderisa në qarkoren buxhetore për Projektbuxhetin 2016 organizatat buxhetore "rekomandoheshin" që të përfshijnë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, nga viti 2017 kjo ishte obligim për të gjitha organizatat buxhetore.²⁸

Por, përkundër këtij obligimi ligjor, në vitin 2017 vetëm 42% e komunave (16 nga 38) dhe vetëm 35% e të gjitha ministrive dhe organizatave të tjera buxhetore paraqitën shtojcën e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor të kërkuar nga MFPT me Kornizën Afatmesme të Buxhetit (KAB).²⁹ Në një analizë të Grupit të Grave Deputete për Projektbuxhetin 2021 thuhej se "nuk ka të dhëna se sa organizata buxhetore plotësojnë tabelat e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor ngase Projektbuxheti për 2021 nuk përmban asnjë nga këto të dhëna".³⁰

23 European Institute for Gender Equality. Gender Budgeting. 2017.

Burimi: <https://bit.ly/2U3jJCR> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

24 Rrjeti i Grave të Kosovës. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor në Nivel Lokal për Kuvende Komunale – udhërrëfyes praktik. Prishtinë, 2015. Burimi: <https://bit.ly/3SYovxQ>

25 Po aty.

26 MFPT. Qarkorja buxhetore 2015/1 për komuna. 14 maj 2014.

Burimi: <https://bit.ly/3L1mMWy> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

27 MFPT. Qarkorja buxhetore 2016/02 për komuna. 31 korrik 2015.

Burimi: <https://bit.ly/3T7wnND> (hapur së fundmi më 6 mars 2023).

28 MFPT. Qarkorja buxhetore 2017/01. 13 maj 2016. Burimi: <https://bit.ly/3ZJA5Pw> (hapur së fundmi më 7 mars 2023).

29 Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës. Analiza Gjinore e Kosovës. Prishtinë, 2018. Burimi: <https://bit.ly/3Zte7R5>

30 Kuvendi i Kosovës – Grupi i Grave Deputete. Analizë e ndikimit gjinor të Projektbuxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021. Nëntor 2020.

Duke parë neglizhencën e institucioneve për të përfshirë procesin e buxhetimit gjinor në planifikimin vjetor të buxhetit, me Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024 i kërkohet MFPT që të bëjë këtë proces të detyrueshëm përmes amendamentimit të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.³¹ Të njëjtin rekomandim e kanë dhënë edhe gratë deputete në Kuvendin e Kosovës në nëntor të 2020.³² Por buxhetimi i përgjegjshëm gjinor ende nuk është përfshirë në Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

4. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në procesin buxhetor

Për të kuptuar se sa nga komunat kanë plotësuar tabelat për buxhetimin e përgjegjshëm gjinor ashtu siç kanë qenë të obliguara me qarkoren buxhetore³³, Instituti GAP ka kërkuar nga MFPT qasje në të gjitha tabelat që kanë dorëzuar komunat nga viti 2017 kur është bërë obligative për organizatat buxhetore që të ofrojnë një analizë për ndikimin gjinor të projektbuxhetit dhe të plotësojnë tabelat për BPGJ.

Të dhënat e siguruara nga MFPT tregojnë se në asnjërin vit që nga viti 2017 nuk ka ndodhur që të gjitha komunat të plotësojnë e të dorëzojnë shtojcat për BPGJ; shumë komuna nuk i kanë plotësuar të gjitha tabelat; disa komuna i kanë dorëzuar tabelat me shumë gabime, duke mos ndjekur udhëzimet sipas qarkores, etj.

5. Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në procesin buxhetor për Buxhetin 2023

As në Ligjin për Buxhetin e Kosovës për vitin 2023 nuk jepen të dhëna sa i përket përfshirjes së buxhetimit të përgjegjshëm gjinor në procesin e hartimit të Projektbuxhetit për vitin 2023. Edhe pse obligim ligjor me Ligjin për Barazi Gjinore, kornizat ndërkombëtare dhe praktikat më të mira të BPGJ-së si PEFA, PEFA GRPFM dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, asnjë tregues i performancës nuk lidhet në mënyrë eksplicite me barazinë gjinore apo buxhetimin e përgjegjshëm gjinor.


Sa i përket të dhënave për punësimin e grave dhe burrave në sektorin publik komunal, për vitin 2023 informata të plota kanë ofruar 33 nga 38 komunat (86.8%).³⁴ Në 33 komunat që kanë plotësuar shtojcën për BPGJ, del se janë të punësuar në total 18,739 gra (48.8%) dhe 19,626 burra (51.2%). Komuna e Dragashit është komuna me numrin më të vogël të grave të punësuar (17%), kurse Komuna e Prishtinës ka shkallën më të lartë të punësimin të grave (64.3%). Gratë janë të nënpërfaqësuar (më pak se 50% të punësimin total) në 20 nga 33 komunat për të cilat ekzistojnë të dhënat.

31 Agjencia për Barazi Gjinore. Programi i Kosovës për Barazi Gjinore 2020–2024, qershor 2020. Fq.23–24. Burimi: <https://bit.ly/41QsUqk> (hapur së fundmi më 7 mars 2023).

32 Kuvendi i Kosovës – Grupi i Grave Deputete. Analizë e ndikimit gjinor të Projektbuxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2021. Nëntor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3L9ZDRo>

33 MFPT. Qarkorja buxhetore 2023/01. 13 maj 2022. Burimi: <https://bit.ly/3ZvdypY> (hapur së fundmi më 7 mars 2023).


34 Të dhëna për punësimin sipas gjinisë nuk kanë ofruar Komuna e Pejës, Prizrenit, Kllokotit, Graçanicës dhe Parteshit.

Figura 1. Numri i punëtorëve të ndarë sipas gjinisë (2023)

Burimi: GAP, bazuar në qarkoret buxhetore 2023

Në anën tjetër 34 nga 38 komunat e Kosovës (89.5%) kanë ofruar informata të plota lidhur me shpërndarjen vjetore të buxhetit në paga.³⁵ Nga të dhënat e Figurës 2, del se pabarazinë më të madhe në shpërndarjen e buxhetit në paga e ka Komuna e Dragashit tek e cila vetëm 17.2% e buxhetit total shpërndahet te gratë. Komuna e cila prinë me shpërndarjen e buxhetit për gratë është Komuna e Fushë Kosovës (67.6%), e pasuar nga Komuna e Prishtinës (64.4%). Në përgjithësi, prej 34 komunave të cilat kanë plotësuar shtojcën për BPGj, në 22 prej tyre (64.7%) burrat marrin pjesën më të madhe të buxhetit të destinuar për paga, ndërsa gratë dominojnë në këtë aspekt te 12 komunat e tjera (35.3%).

35 Të dhëna për koston e stafit sipas gjinisë nuk kanë ofruar Komuna e Prizrenit, Klllokotit, Graçanicës dhe Parteshit.

Figura 2. Shpërndarja e buxhetit në paga sipas gjinisë (2023)


Burimi: GAP, bazuar në qarkoret buxhetore 2023

Sa i përket numrit të grave dhe burrave që pritet të përfitojnë subvencione komunale për vitin 2023, informata të plota kanë ofruar 25 komuna (65.8% e komunave).³⁶ Në total te këto komuna parashihet të subvencionohen projektet dhe aktivitetet e 9,927 grave (52.2%) dhe 9,102 burrave (47.8%). Komuna e Shtimes është komuna me përqindjen më të madhe të grave përfituese (76.9%), e pasuar nga Komuna e Gjilanit (75%), dhe ajo e Mamushës (69.2%). Ndërsa, komunat tek të cilat burrat përbëjnë pjesën më të madhe të përfituesëve janë Komuna e Vushtrrisë (83.9%), Komuna e Ranillugut (80%), dhe Komuna e Gjakovës (65.3%).

36 Të dhëna për numrin e përfituesëve të subvencioneve sipas gjinisë nuk kanë ofruar Prizrenit, Graçanicës, Istogut, Kamenicës, Klinës, Kllokotit, Lipjanit, Malishevës, Mitrovicës së Jugut, Novobërdës, Parteshit, Prishtinës dhe Rahovecit

Te komunitat që kanë plotësuar shtojcën për BPGj, gratë dominojnë numrin e përfituesve të subvencioneve në 12 komuna (48%), burrat në 11 komuna (44%), si dhe në 2 komuna (8%) kemi shpërndarje të barabartë mes dy gjinive. Por përkundër asaj që në vitin 2023 parashihet që në total më shumë gra se burra të përfitojnë subvencione nga komunitat, sa i përket vlerës së subvencionimit në mesatare burrat subvencionohen në vlera më të larta monetare (mesatarisht 695 euro), se sa gratë (mesatarisht 609 euro).


Figura 3. Numri i përfituesëve të subvencioneve sipas gjinisë (2023)



Burimi: GAP, bazuar në qarkoret buxhetore 2023

Informata të plota lidhur me shumën e subvencioneve të planifikuara e të ndara sipas gjinisë kanë ofruar 26 nga 38 komunitat (68.4%).³⁷ Nga komunitat që kanë plotësuar shtojcën për BPGj, vetëm Komuna e Zveçanit parashikon shpërndarje të barabartë të shumës së subvencioneve për të dy gjinitë. Gratë dominojnë në shumën e subvencioneve të ndara te tetë komuna (30.8%), ndërsa burrat dominojnë në 17 komuna (65.4%). Komuna e Shtimes është komuna e cila prinë me shpërndarjen e shumës së subvencioneve për gratë (76.7%), e pasuar nga ajo e Ferizajit (63.9%). Ndërsa, komuna e cila prinë me shumën e subvencioneve të ndara për burrat është Komuna e Malishevës (81.5%), e pasuar nga Komuna e Ranillugut (81%) dhe ajo e Shtërpçës (80%).

37 Të dhëna për shumën e subvencioneve të ndara sipas gjinisë nuk kanë ofruar Komuna e Prizrenit, Graçanicës, Kamenicës, Klinës, Kllokotit, Lipjanit, Malishevës, Mitrovicës së Jugut, Novobërdës, Parteshit, Prishtinës dhe Rahovecit

Figura 4. Shpërndarja e subvencioneve sipas gjinisë (2023)


Burimi: GAP, bazuar në qarkoret buxhetore 2023

Në anën tjetër 25 nga 38 komunitat e Kosovës (65.8%) kanë ofruar informata të plota lidhur me numrin e përfituesëve të subvencioneve dhe shpërndarjen e subvencioneve, gjë që ka mundësuar edhe gjetjen e vlerës mesatare të subvencioneve të ndara në bazë të gjinisë.³⁸ Komuna e Vushtrrisë është komuna e cila prinë me vlerën më të madhe mesatare të subvencioneve të ndara për gratë, përkatësisht me 2,384 euro të ndara për një përfituese grua dhe 603 euro të ndara për një përfitues burrë. Komunitat e tjera tek të cilat gratë dominojnë në vlerën e subvencionimit në mesatare krahasim me burrat (ndonëse në shifra të vogla) janë edhe Komuna e Zhubin Potokut, Junikut, Deçanit, dhe ajo e Obiliqit. Në përgjithësi të gjashtë nga 25 komunitat (24%) që kanë plotësuar shtojcën për BPGj kemi shpërndarje të barabartë të mesatares së subvencioneve. Ndërsa, të 14 nga 25 komunitat e paraqitura në figurën e mëposhtme (56%), burrat marrin vlerën më të madhe mesatare në shumën e subvencionimit. Te këto komuna diferenca më e madhe në favor të burrave shkon te Komuna e Mamushës, tek e cila ndonëse numri i përfituesëve është në favor të grave (figura 3), gratë marrin në mesatare vetëm 144 euro për subvencionim, ndërsa burrat 1,435 euro.

38 Të dhëna për numrin e përfituesëve të subvencioneve dhe shumën e subvencioneve të ndara sipas gjinisë nuk kanë ofruar Prizrenit, Graçanicës, Kamenicës, Klinës, Kllokotit, Lipjanit, Malishevës, Mitrovicës së Jugut, Novobërdës, Parteshit, Prishtinës dhe Rahovecit. Në anën tjetër, Komuna e Istogut nuk ka ofruar të dhëna lidhur me numrin e përfituesëve të subvencioneve.


Diferenca të mëdha në favor të burrave kemi edhe te Komuna e Gjilanit tek e cila 25 përfitues burra marrin në mesatare 22,600 euro subvencionim. Ndërsa, komunat e tjera të cilat kanë diferenca të theksuara në favor të burrave janë dhe Komuna e Shtërpçës, Skënderajit, dhe Hanit të Elezit.

Figura 5. Vlera mesatare e subvencioneve të përfituara sipas gjinisë, 2023



Burimi: GAP, bazuar në qarkoret buxhetore 2023

Sa i përket shpërndarjes së pagave sipas nivelit, 31 nga 38 komunat (81.6%) kanë ofruar të dhëna për numrin e stafit që merr paga mes 201 deri 400 eurove, 401 deri 600 euro dhe mbi 600 euro. Të dhënat tregojnë se në Komunën e Prishtinës gratë janë më të shumta në numër në kategorinë e pagave mbi 600 euro, kurse në të gjitha komunat tjera burrat dominojnë në pozitë ku niveli i pagave është mbi 600 euro.

Figura 6. Numri i stafit i ndarë sipas gjinisë e që merr paga mbi 600 €

Burimi: GAP, bazuar në qarkoret buxhetore 2023

Me Ligjin për barazi gjinore dhe me qarkoret buxhetore të lëshuara nga MFPT, përveç plotësimit të tabelave për BPGj, kërkohet që organizatat buxhetore të bëjnë të dukshme edhe efektet e shpenzimeve publike në barazinë gjinore, si dhe të përfshijnë vërejtjet e zyrtarëve për barazi gjinore. Analiza e PEFA-s në vitin 2021 gjente se asnjë organizatë buxhetore e nivelit qendrorë nuk kryen analizë gjinore gjatë procesit të hartimit të projektbuxhetit.³⁹ Gjatë këtij hulumtimi Institutit GAP ka arritur të siguroj të dhëna se në vitin 2022 vetëm dy komuna kanë kryer analizë gjinore për efektet e të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore tek gratë dhe burrat: Komuna e Gjakovës dhe ajo e Obiliqit.

39 PEFA. Public Expenditure and Financial Accountability (PEFA) Performance Assessment Report – Supplementary Framework for Assessing Gender Responsive Public Financial Management (Annex VI). 17 February 2022. Faqe: 179.
Burimi: <https://www.pefa.org/node/5072>

Mirëpo, edhe tek këto dy komuna, analizat përmbajnë kryesisht të dhëna rreth ndarjes së buxhetit dhe numrit të të punësuarve sipas gjinisë për drejtoritë komunale. Ndërsa, përveç të dhënave rreth shpenzimeve buxhetore sipas gjinisë tek kategoria e subvencioneve, aty nuk paraqiten të dhëna për pjesëmarrjen e grave në marrjen e vendimeve apo vënien e prioriteteve për investime kapitale, të dhëna rreth ndikimit gjinor për shërbimet komunale, etj.

Po ashtu, Instituti GAP ka identifikuar dhjetë projekte të mëdha kapitale të parapara me buxhetin e komunave për vitin 2023 (Tabela 1), me investime mbi një milion euro, por asnjëra nga komunat nuk kanë ofruar dëshmi se a është kryer analiza e ndikimit gjinor.

Tabela 1. Lista e disa nga projektet me vlerën më të madhe investive, 2023

Komuna	Emri i Projektit	Vlera (€)	Analiza e ndikimit gjinor?	
1	Prishtinë	Rruga A (kolektori dhe rruga)	4,000,000	Jo
2	Obiliq	Instalimi i ngrohjes qendrore në Qytetin e Obiliqit – Kogjenerimi	3,300,000	Jo
3	Prishtinë	Efiqienca e Energjisë ne Ndertesat Publike ne Prishtine	3,000,000	Jo
4	Gjilan	Ndërtimi i parkut "Livadhet e Arapit", "Fidanishtja I", "Kodra e Dëshmorëve"...	2,500,000	Jo
5	Prishtinë	Ndertimi i parqeve dhe hapësirave te reja publike rekreative ne Kalabri, Mat,Zona qender,Kodra e Trimave ,Barileve / Drenoc ,Gollaku, Ulpiana – rr. "Eqrem Qabej" – Xhepat urban – Blloku 1 -Vellushe – Bregu i Diellit – Arberi – Parku ne Mat 2 – Rruga Isa Kastrati – Parku i Gallapit – lagjia e Medreses	2,150,000	Jo
6	Gjakovë	Ndërtimi i Qarkorës së Qytetit	1,500,000	Jo
7	Prishtinë	Ndertimi i Spitalit te Prishtines	1,300,000	Jo
8	Gjakovë	Ndërtimi i Stadionit të Qytetit	1,100,000	Jo
9	Obiliq	Ndërtimi i dy sallave të edukatës fizike SHFMU.Dr.Ibrahim Rugova Mazgit dhe Abdurrahmon Gerguri ne Dardhishte	1,028,000	Jo
10	Deçan	Ndertimi i rrugeve,trotuareve dhe asfaltimi i tyre ne regjionet e Vokshit, Isniq, Irzniq, Strellc	1,020,000	Jo

Vetëm plotësimi i tabelave për BPGj sipas qarkoreve buxhetore, duke mos i përdorur ato të dhëna për analizë gjinore dhe për hartimin e politikave që qojnë në barazi mes grave dhe burrave, nuk mund të konsiderohet si proces i plotë e që respekton standardet e një buxhetimi të përgjegjshëm gjinor të mirëfilltë.

6. Përfundim dhe rekomandime

